



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu

Ftesë për pjesëmarrje në forumin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Greqisë dhe takime B2B ndërmjet bizneseve kosovare dhe greke

05 shtator, 2024
Kosovë, Prishtinë

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja dhe rritjes së gamës së produkteve për eksport, si dhe tërheqjes së investimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse, fton bizneset vendore për pjesëmarrje në forumin ekonomik që do të mbahet me 05 shtator, 2024 në Prishtinë, ndërmjet Kosovës dhe Greqisë. Fokus të veçantë në këtë forum do të kenë takimet B2B ndërmjet bizneseve kosovare dhe bizneseve greke, si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet KIESA-s dhe agjencisë homologe greke për zhvillim të biznesit Enterprise Greece.

Forumi ekonomik ka për qëllim thellimin e bashkëpunimit bilateral dhe për të krijuar lidhje në mes ndërmarrjeve kosovare dhe atyre greke, për të hapur mundësi të reja për rritje të bashkëpunimit në fushën e investimeve dhe eksporteve. Bizneset vendore të ftuara për pjesëmarrje në forum, janë nga sektorët si në vijim:

-  Sektori i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
-  Sektori i farmaceutikës;
-  Sektori ushqimor;
-  Sektori i energjisë së ripërtëritshme;
-  Sektori i drurit, metalit dhe ndërtimit dhe
-  Sektori i turizmit.

Për të qenë pjesë e forumit ekonomik dhe takimeve B2B, bizneset duhet dorëzuar dokumentet si në vijim:

1. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të biznesit;
2. Dëshminë që biznesi është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të biznesit dhe
4. Deklaratën nën betim.

Dokumentet e lartpërmendura duhet t'i dërgojnë në mënyrë elektronike më së largu deri më 23.08.2024 në orën 16:00, në e-mail adresën si në vijim:

⇒ invest.kiesa@rks-gov.net

Informata shtesë rreth aktivitetit mund të merren në MINT/KIESA përmes linjave telefonike si në vijim:

⇒ +383 (38) 200 36 585

⇒ +383 (38) 200 36 586